



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 481 / Prot.

10

Tiranë, më 14.02.2023

VENDIM

Nr. 15, datë 14.02.2023

“PËR TARIFAT E KONKURRIMIT, APLIKIMIT DHE SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË TË SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023”

Në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 51 (gërma x) të Statutit dhe nenit 34 të Rregullores së UMT-së; të Vendimit nr. 98, datë 29.12.2022 “Për miratimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2022-2023, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të Senatit Akademik; Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 14.02.2023;

VENDOSI:

- Të miratojë, të pandryshuar:
 - tarifën e konkurrimit në programet e studimeve të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë në masën 5,000 (pesë mijë) lekë.
 - tarifën e aplikimit për transferim të studimeve në programet e ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë në masën 5,000 (pesë mijë) lekë.
 - tarifën vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të tretë të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë në masën 115,000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
- Studentët që shpallen fitues, paguajnë/arkëtojnë menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera paguhen sipas afateve dhe masës, që përcaktohet nga fakultetet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohen administratorët e njësive kryesore, që ofrojnë programe specializimi dhe Administratori i UMT-së për zbatimin e tij.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË
VERA OSTRENI

MONIKA FIDA

ALTINA XHAFFERI

ANIS THODHORJANI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ